



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA E APELIT PRISHTINË**

Numri i lëndës: 2019:200656

Datë: 11.03.2024

Numri i dokumentit: 05436438

Ac.nr.2712/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Adnan Konushevci - kryetar i kolegjit, Halide Reka dhe Naime Ahmeti, anëtare të kolegjit, në çështjen juridike - kontestimore të paditëses Kompania e Sigurimeve “Insig në Likuidim”, me seli në Prishtinë, kundër të paditurit F.B.U nga P Rruga ”H.Z”, Nr.66, baza juridike rimbursim dëmi, vlera e kontestit 1,465.00 euro, duke vendosur në lidhje me ankesën e të paditurit, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Podujevë, C.nr.568/2016 i datës 25.02.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 08.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET e themeltë ankesa e përfaqësuesit të paditurit F.B.U nga P Rruga ”H.Z”, Nr.66, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Podujevë, C.nr.568/2016 i datës 25.02.2021, PRISHET dhe çështja i kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim dhe vendosje të serishme.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.568/2016 i datës 25.02.2021, ka vendosur si në vijim: *“I. APROVOHET në tersi SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditëses Kompania e Sigurimeve “Insig në Likuidim” me seli në Prishtinë dhe DETYROHET i paditurit Festim Bajram Uka nga P, që paditëses në emër të rimbursimit të dëmit - borxhit të shkaktuar të dëmtuarës në aksidentin e dt.13.01.2014, në shumën prej 1.465.00 euro me kamatën të cilën e paguajnë bankat afariste të R. Kosovës, për mjetet e deponuara për një vit, pa destinim të caktuar, duke filluar ti llogaritet nga dita e nxjerrjes së këtij aktgjykimi e deri në pagesën*

definitive. Shumën e aprovuar i padituri detyrohet t'ia paguaj paditëses në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcenim të përmbarimit me dhunë dhe II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale”.

Kundër këtij aktgjykimi ankesë në afat ligjor ka paraqitur i padituri për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që aktgjykimi i shkallës së parë të priset dhe çështja të kthehet në rigjykim gjykatës së shkallës së parë.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur paditësja.

Gjykata e Apelit në seancën e kolegjit, e ekzaminojë aktgjykimin e shkallës së parë në bazë të nenit 194 lidhur me nenin 208, të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore dhe gjeti se:

- Ankesa e të paditurit është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja, me datë 27.12.202016, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi, me të cilën ka kërkuar rimbursim i borxhit me arsye sikurse në padi.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të te gjitha shkresave tjera të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.568/2016 i datës 25.02.2021, me të cilin e ka aprovuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se ka duke u mbështetur në rregullativën në fuqi paditësja ka qenë e obliguar që të përmbushë detyrimin ndaj palës së dëmtuar, duke i kompensuar dëmin e shkaktuar nga i siguruari i saj. Bazuar në dispozitat të LMD-së vitit 2013 është përcaktuar se: “Me pagimin e shpërblimit nga sigurimi kalojnë në siguresin në bazë të ligjit deri në shumën e shpërblimit të paguar të gjitha të drejtat e të siguruarit, kundrejt të gjithë personave, të cilët mbi çfarëdo baze janë përgjegjës për dëmin e i cili përcakton se: “pas pagimit të dëmshpërblimit, mund të bëhet rimbursimi i shumës së paguar, në bazë të kërkesës për regres nga pronari apo shfrytëzuesi i regjistruar i automjetit i cili nuk ka siguruar automjetin duke llogaritur kumatën dhe shpenzimet“. Kjo çështje është e rregulluar dhe me dispozitat e LSDA nr.04/L-018 në nenin 14 par.2 dhe 3 ku thuhet se: ”Humb mbulesa siguroese e policës së sigurimit kur drejtuesi i mjetit që shkakton aksidentin është nën ndikimin e alkoolit apo është i pa pajisur me dëshminë adekuate për drejtimin e një mjete të tillë“ pra pa patentë shofer. Gjykata duke pasur parasysh faktin se i padituri i ka pohuar faktet vendimtare,

përkundrejt kontestimit të kërkesëpadsisë, ka vlerësuar se në këtë çështje juridike kontestuese nuk është e nevojshme mbajtja e shqyrtimit kryesor dhe administrimi i provave për faktet e pohuara. Nuk qëndron kundërshtimi i paditurit se paditësja nuk ka të drejtë të kërkoj kompensimin e dëmit material dhe jo material sepse kjo është e rregulluar me LSDA neni 14 paragrafi 2 dhe 3 për sigurimet e detyrueshme nga auto përgjegjësia.

Për kamatën ka vendosur konform nenit 277 të LMD-së (LMD i vjetër), ndërsa për shpenzimet e procedurës ka vendosur konform nenit 450 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i Gjykatës së shkallës së parë nuk është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që Aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 pika n) e LPK-së, lidhur me nenin 152 të LPK-së.

Gjykata ankimore duke i vlerësuar pretendimet ankimore të palës së paditur gjen se të njëjtat qëndrojnë pasi që ekzistojnë shkelje nga neni 182.2 pika n) e LPK-së, për arsye se aktgjykimi ka të meta për shkak të te cilave nuk mund të ekzaminohen, e sidomos dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm, kontradiktor me vetvete dhe me arsyet e aktgjykimit.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet ligjore që të merret aktgjykim pa shqyrtim gjyqësor të kësaj çështje, për arsye se nuk qëndron përfundimi i Gjykatës së shkallës së parë se pala e paditur nuk i ka kontestuar thëniet në padi me anë të përgjigjes në padi, që në fakt i paditur e ka kundërshtuar padinë me anë të përgjigjes në padi dhe ka theksuar se në atë rast nuk është lënduar askush sipas të paditurit.

Me Nenin 152 i LPK-së përcakton se: *“Po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadsisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij.”*

Nga përgjigja në padi e parashtruar nga ana e të paditurit edhe pse i njëjti nuk e ka kontestuar bazën juridike të kërkesëpadsisë, i njëjti e konteston dëmin e shkaktuar dhe lartësinë e dëmit, si dhe po ashtu cek faktin se të automjeti tjetër tani është ndërruar edhe drejtuesi i automjetit kinse ai ka qen duke e drejtuar automjetin në kohën kur kanë aksidentuar.

Gjykata e shkallës së parë nuk i ka vlerësuar në mënyrë të drejtë kundërshtimet e palës së paditur, ashtu që gabimisht ka marrë aktgjykim pa shqyrtim kryesor të çështjes dhe e ka aprovuar

kërkesëpadinë e paditëses, pa i vlerësuar të gjitha faktet vendimtare që qojnë në një përfundim të tillë.

Pala e paditur në përgjigje në padi, me këmbëngulësi ka kontestuar dëmin dhe lartësinë e dëmit duke pretenduar se paditësja nuk ka ofruar prova të mjaftueshme mirëpo përkundër këtyre kundërshtimeve Gjykata e shkallës së parë ka marrë aktgjykim pa shqyrtim kryesor të çështjes, kështu duke aplikuar gabimisht dispozitat ligjore për çka kjo Gjykatë vlerëson se aktgjykimi si i tillë nuk mund të qëndrojë dhe detyrimisht duhet anuluar.

Meqenëse, Gjykata e Apelit gjeti se ekzistojnë shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, nuk u lëshua në pretendimet për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimin e gabuar të së drejtës materiale.

Në ri procedurë Gjykata e shkallës së parë duhet të veprojë konform vërejtjeve të dhëna nga Gjykata ankimore ashtu që fillimisht të eliminojë shkeljet e dispozitave të procedurës Kontestimore, të caktojë seancën e shqyrtimit kryesor duke siguruar praninë e palëve ndërgjyqëse në procedurë, të vlerësojë thëniet e palës paditëse dhe asaj të paditur, dhe sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së parë mund të nxjerr provën me ekspertizë përkatëse varësisht nga deklarimi i ndërgjyqësve në seancë, pas sqarimit të këtyre rrethanave, e në përputhje me provat e tjera që mund të paraqiten në seancë, nga palët ndërgjyqëse të vërtetojë përgjegjësinë eventuale të palës së paditur, të vërtetojë drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, e më pas të marrë vendim të drejtë dhe të ligjshëm, e gjithmonë duke iu përmbajtur dispozitës së nenit 160 të LPK-së, lidhur me përpilimin e aktgjykimit.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, e në pajtim me nenin 194, 195 paragrafi 1 pika c) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.2712/2021 me datë 08.03.2023

Kryetari i kolegjit
Adnan Konushevci d.v.